



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 362/1 prot.

Tiranë, më 31. 05. 2021

V E N D I M

Nr. 94, datë 31. 05. 2021

Mbështetur në ligjin Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 146, datë 02.12.2020, e shtetasit B. I., kundër Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Drejtësisë Tiranë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të gjendjes arsimore¹ dhe vendbanimit².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesi sqaron se, ka përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” në Elbasan. Në vijim, ka aplikuar pranë Fakultetit të Drejtësisë Tiranë për të ndjekur ciklin e dytë të studimeve Master dhe si preferencë të parë ka vendosur programin Master Shkencor Civil.

Në përfundim, referuar renditjes së kandidatëve dhe pikëve të grumbulluara, ankuesi është shpallur fitues vetëm në programin e studimeve Master Profesional Publik dhe jo në programin Master Shkencor Civil.

Situata e mësipërme dhe skualifikimi i tij, sipas ankuesit ka ardhur si pasojë e urdhërit nr. 40, datë 30.09.2020, të Fakultetit të Drejtësisë Tiranë, në të cilin janë përcaktuar kriteret e pranimit të aplikimeve për ndjekjen e programeve të studimeve të ciklit të dytë në vitin akademik 2020-2021. Në përmbajtje të urdhërit të sipërcituar, është vendosur që: “Kuotat fillestare do të plotësohen duke u dhënë prioritet aplikantëve që kanë përfunduar studimet ‘Bachelor’ në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, si dhe aplikantëve që kanë përfunduar studimet ‘Bachelor’ në Institucionet e Arsimit të Lartë jashtë vendit.

¹ Për shkak se ankuesi ka përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor në Elbasan.

² Për shkak se ankuesi ka përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor në Elbasan.

Kuotat e paplotësuara nga kategoria e mësipërme, do të plotësohen nga aplikantët që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në institucionet e tjera publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në degën Drejtësi; si edhe në degën “Ekonomi” për “Master Profesional EU Business Law.

Kuotat e paplotësuara nga kategoritë e mësipërme, do të plotësohen nga aplikantët që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në institucionet e tjera jopublike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në degën Drejtësi.

Pra, sipas ankuesit, nga ana e Fakultetit të Drejtësisë Tiranë, janë përzgjedhur fillimisht si kandidat fitues, aplikantët që kanë përfunduar studimet Bachelor në këtë fakultet dhe ata jashtë vendit, e më pas i është dhënë mundësia kandidatëve që vijnë nga fakultete të tjera të Universitetit të Tiranës dhe universiteteve të tjera të Shqipërisë.

Në këto kushte, ankuesi pretendon se ai dhe aplikantët e tjerë të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të, janë diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore dhe vendbanimit, nga ana e aktit të nxjerrë nga Fakulteti i Drejtësisë së Universitetit të Tiranës, duke qënë se në mënyrë direkte ky urdhër favorizon aplikantët që kanë përfunduar studimet në këtë fakultet dhe ata që kanë përfunduar studimet Bachelor në Institucionet e Arsimit të Lartë jashtë vendit.

Në zbatim të ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të tij dhe aplikantëve që ndodhen në të njëjtat kushte me të; rishikimin apo ndryshimin e Urdhrit nr. 40, datë 30.09.2020 të Fakultetit të Drejtësisë Tiranë dhe rishpalljen e kandidatëve fitues në ciklin e dytë të studimeve “Master Shkencor” dhe “Master Profesional” në Fakultetin e Drejtësisë Tiranë, sipas parimit të meritokracisë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së³, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i*

³ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës së B. I. u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/4 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1674/1 prot., datë 10.12.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion⁴ nga Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Drejtësisë Tiranë për ankesën e bërë nga B. I.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Universiteti i Tiranës me anë të shkresës⁵ nr. 3450/2 prot., datë 24.12.2020, sqaroi ndër të tjera se: “...pretendimi i ankuesit se është diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore dhe vendbanimit nuk qëndron, pasi B. I., jo vetëm është njohur paraprakisht me kriteret e vendosura dhe ka rënë dakord me to, me anë të plotësimit dhe nënshkrimit të formularit të aplikimit, por edhe ka pranuar shpalljen fitues në programin Master Profesional Publik, pasi është paraqitur pranë Fakultetit të Drejtësisë ku është regjistruar si fitues në datën 10.12.2020 dhe ka shprehur vullnetin e tij të plotë me anë të firmosjes në Regjistrin e fituesve për Programin Master Profesional me kohë të plotë - Drejtimi Publik, fakt i cili dëshmon se ai tashmë është student i FDUT-së dhe bie në kundërshtim me pretendimet e ngritura prej tij (bashkëngjitur formulari i regjistrimit dhe fleta përkatëse në Regjistër)...Neni 57 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë e ka kushtëzuar ndjekjen e arsimit të lartë vetëm mbi kritere aftësie, që do të thotë se jo çdo shtetas që dëshiron të ndjekë një program studimi të ciklit të parë apo të dytë, në një institucion të arsimit të lartë, mund të fitojë këtë të drejtë. Kushtetuta gjithashtu në nenin 57, pika 7, ka sanksionuar lirinë akademike dhe autonominë universitare si parimet bazë

⁴ - Argumentimin, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.

- Informacion lidhur me arsyet që kanë çuar në vendosjen e kriterëve për plotësimin e kuotave duke u dhënë prioritet aplikantëve që kanë përfunduar studimet ‘Bachelor’ në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, si dhe aplikantëve që kanë përfunduar studimet ‘Bachelor’ në Institucionet e Arsimit të Lartë jashtë vendit.

- Informacion nëse ka patur raste të tjera ku aplikantët kanë paraqitur ankesë përse është parashikuar në urdhrin nr. 40, datë 30.09.2020. Nëse po, të vihet në dispozicion të Komisionerit kopje të këtyre shkresave/ankesave.

⁵ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1837 prot., datë 28.12.2020

mbi të cilat ndërtohet dhe funksionon arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, zbatimi të cilave garantohet me ligj.

Një ndër elementët e autonomisë universitare është ajo organizative, e cila garantohet edhe nëpërmjet së drejtës për të caktuar kritere për pranimin e studentëve në programet e studimit, në përputhje me ligjin nr. 80/2015 'Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë'. Neni 25 i Ligjit Nr. 80/2015, ka parashikuar departamentin si organin përgjegjës për përcaktimin e kritereve të pranimit për çdo program studimi, i cili jo vetëm propozon kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, por edhe përzgjedh studentët fitues, të cilët miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, sipas procedurave të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë.

Pra, nisur nga rregullimet ligjore të sipërcituara, njësitë bazë të Fakultetit të Drejtësisë të UT-së, me qëllim realizimin me sukses të procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimeve të ciklit të dytë, për vitin akademik 2020-2021, kanë përcaktuar këto kritere:

- 1. Nota mesatare minimale për të aplikuar për Master Shkencor është 6.5 (gjashtë pikë pesë).*
- 2. Nota mesatare minimale për të aplikuar për Master Profesional është 5 (pesë).*
- 3. Nota mesatare minimale për të aplikuar për Master Profesional EU Business Law është 5 (pesë).*
- 4. Niveli minimal i njohjes së një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, është B 1; (Ky kriter është i zbatueshëm vetëm për kandidatët që aplikojnë për "Master Shkencor").*

Gjithashtu njësitë bazë kanë përcaktuar edhe mënyrën e plotësimit të kuotave, sipas këtij rendi:

- i. Kuotat fillestare do të plotësohen duke u dhënë prioritet aplikantëve që kanë përfunduar studimet "Bachelor" në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, si edhe aplikantëve që kanë përfunduar studimet "Bachelor" në Institucionet e Arsimit të Lartë jashtë vendit.*
- ii. Kuotat e paplotësuara nga kategoria e mësipërme, do të plotësohen nga aplikantët që kanë përfunduar studimet "Bachelor" në institucionet e tjera publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në programin Drejtësi; si edhe në programin "Ekonomi" për "Master Profesional EU Business Law".*
- iii. Kuotat e paplotësuara nga kategoritë e mësipërme, do të plotësohen nga aplikantët që kanë përfunduar studimet "Bachelor" në institucionet e tjera jopublike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në programin "Drejtësi".*

Informacioni i mësipërm është vënë në dispozicion të kandidatëve të interesuar në datën 1 tetor 2020, duke u afishuar në vende të dukshme, në mënyrë që aplikantët të ishin në dijeni të plotë të kritereve dhe të mënyrës së plotësimit të kuotave.

B. I. është paraqitur pranë Fakultetit të Drejtësisë së UT, për të aplikuar në ciklin e dytë të studimeve "Master i Shkencave" dhe "Master Profesional". Aplikimi i B. I. është plotësuar dhe nënshkruar me vullnet të plotë prej tij, duke renditur preferencat për të gjitha programet e ciklit të dytë të studimeve që ofron Fakulteti i Drejtësisë të UT, si më poshtë vijon (bashkëngjitur kopje e aplikimit):

1. Master Shkencor Civil (1)
2. Master Shkencor Penal (6)
3. Master Shkencor Publik (3)
4. Master Profesional Civil (2)
5. Master Profesional Penal (7)
6. Master Profesional Publik (4)
7. Master Profesional EU Business Law (5)

Komisioni i ngritur për përzgjedhjen e kandidatëve fitues për programet e studimeve të ciklit të dytë në vitin akademik 2020-2021, pasi ka shqyrtuar plotësimin e kriterëve dhe preferencat sipas Fletë Aplikimit të ankuesit, ka arritur në këto përfundime:

- *B. I. nuk është shpallur fitues në preferencën e tij të parë (1), pasi kuotat janë plotësuar me aplikantë që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, si edhe aplikantëve që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në Institucionet e Arsimit të Lartë jashtë vendit.*
- *B. I. nuk është shpallur fitues në preferencën e tij të dytë (2), pasi kuotat janë plotësuar me aplikantë që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, 1 aplikant që ka përfunduar studimet “Bachelor” në Institucionet e Arsimit të Lartë jashtë vendit, si dhe 3 aplikantë që kanë përfunduar studimet Bachelor në institucionet e tjera publike të Republikës së Shqipërisë, por që ndryshe nga B. I. këtë program studimi e kanë pasur preferencë të parë (1).*
- *B. I. nuk është shpallur fitues në preferencën e tij të tretë (3), pasi kuotat janë plotësuar me aplikantë që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.*
- *B. I. është shpallur fitues në programin e studimit Master Profesional në të “Drejtë Publike”, që rezulton të jetë edhe preferenca e tij e katërt (4).*

Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit në Udhëzimin nr. 17, datë 30.07.2019, ka përcaktuar procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit të dytë të studimeve në IAL. Në pikën 13, ky Udhëzim ka përcaktuar se kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda 3 ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda dy ditëve pune, nga data e paraqitjes së ankesave.

Nuk rezulton që ankuesi B. I. të ketë paraqitur ankimim, për shkak të rezultateve të shqyrtimit të aplikimit të tij. Po kështu, nuk rezulton të jetë paraqitur asnjë ankesë tjetër sa i përket parashikimeve në Urdhrin nr. 40, datë 30.09.2010 të Fakultetit të Drejtësisë.

Nisur nga sa u parashtrua më sipër, pretendimi i ankuesit se është diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore dhe vendbanimit nuk qëndron, pasi B. I. është njohur paraprakisht me kriteret e vendosura dhe ka rënë dakort me to, duke plotësuar dhe nënshkruar formularin e aplikimit. Atij nuk i është mohuar e drejta për aplikim dhe as e drejta për të vazhduar studimet e ciklit të dytë. B. I. është shpallur fitues në programin Master Profesional Publik dhe është paraqitur pranë Fakultetit të Drejtësisë ku është regjistruar si fitues në datën 10.12.2020, fakt i cili

dëshmon se ai tashmë është student i FDUT-së dhe bie në kundërshtim me pretendimet e ngritura prej tij (bashkëngjitur formulari).

Pra, nuk kemi të bëjmë me diskriminim, pasi kriteret janë të njëjta për të gjitha programet e studimit që ofrohen nga Fakulteti i Drejtësisë, UT dhe shpallja e B. I. fitues në njërin prej programeve të studimeve të ciklit të dytë, rrëzon pretendimet e tij për diskriminim.

Pretendimi i ankuesit që ai dhe aplikantë të tjerë të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të, janë diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore dhe vendbanimit nuk qëndron, pasi rezulton se në përfundim të dy fazave të para të aplikimit, nga 75 aplikantë nga institucionet e tjera publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, deri në datë 17.12.2020, 55 prej tyre janë shpallur fitues në një prej programeve të studimit në të cilat kanë aplikuar. Theksojmë se, procesi ende nuk ka përfunduar, çka do të thotë se edhe aplikantët e mbetur të pa trajtuar nga dy fazat e para, do të kenë mundësi të trajtohen në vijim.

Sa u parashtrua më sipër, rezulton se nga ana e Fakultetit të Drejtësisë është zbatuar drejtë legjislativi në fuqi për arsimin e lartë, procesi është zhvilluar në mënyrë transparente bazuar në parimin meritë-preferencë. Ankuesi, B. I., është njohur paraprakisht me kriteret e aplikimit të vendosura dhe të shpallura publikisht, ka rënë dakort me to, ka rezultuar fitues në një program studimi dhe është regjistruar me vullnetin e tij të plotë në të.”

Gjithashtu, Fakulteti i Drejtësisë Tiranë, në përgjigje të shkresës së sipërcituar, me shkresën⁶ nr. 752/9 prot., datë 17.12.2020, mbajti të njëjtin qëndrim dhe parashtrime me Universitetin e Tiranës, duke sqaruar procedurën e ndjekur dhe fituesit për kuotat e Programeve të Studimit Master.

- Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës së B. I., Komisioneri me shkresën Nr. 362 prot., datë 23.02.2021, njoftoi zhvillimin e seancës dëgjimore në datë 02.03.2021 duke kërkuar shpjegime shtesë.

Seanca u zhvillua në datën 02.03.2021, me praninë e palëve: përfaqësueses⁷ së Universitetit të Tiranës dhe përfaqësueses⁸ së Fakultetit të Drejtësisë. Pavarësisht se ankuesi, kishte marrë dijeni mbi njoftimin për seancë dëgjimore, nuk u paraqit.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, u njoftuan palët se seanca dëgjimore do të mbahej në procesverbal dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, palët i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

⁶ Protokolluar pranë KMD-së me nr. 1674/2 prot., datë 18.12.2020.

⁷ Shtetases V. N., me autorizim Nr. 3450/4 prot., datë 26.02.2021.

⁸ Shtetases E. B., me autorizim Nr. 160/1 prot., datë 26.02.2021.

Në vijim të seancës dëgjimore përfaqësuesit e Fakultetit të Drejtësisë dhe Universitetit të Tiranës, sqaruan se parashtrimet e tyre do t'i vënë në dispozicion të Komisionerit në ditët në vijim. Përfaqësuesja e Fakultetit të Drejtësisë shtoi faktin se ankuesin e kishte penalizuar përzgjedhja, nota mesatare dhe renditja e preferencave të bëra. Sa i përket, studentëve të Fakultetit të Drejtësisë dhe atyre që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve jashtë vendit, ajo sqaroi se janë në të njëjtat kushte.

- Në përgjigje të kërkesave të paraqitura nga Komisioneri gjatë seancës dëgjimore, Universiteti i Tiranës me shkresën⁹ Nr. 3450/5 prot., datë 11.03.2021, sqaroi ndër të tjera se: *“Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës (UT), ofron 7 programe studimi në Ciklin e Dytë të studimit, si: 4 Programe studimi Master Profesional dhe 3 Programe studimi Master Shkencor, të cilët pasqyrohen edhe në formularin e aplikimit që ju vihet në dispozicion atyre që paraqiten për të aplikuar...Pas dorëzimit të dokumentacionit përkatës dhe kryerjes së procedurës së aplikimit, B. I. është pajisur edhe me numrin e tij të aplikimit, konkretisht Nr.2. Gjithashtu, në momentin e aplikimit ka plotësuar dhe firmosur edhe një deklaratë, në të cilën deklaroi me vullnetin e tij të lirë se: ‘Deklaroj se jam njohur në momentin e aplikimit me kriteret e pranimit në programin e studimit, si dhe pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi dhe jam dakord me për sa më sipër’. Të dyja këto dokumente, - formulari i aplikimit dhe deklarata, janë plotësuar dhe firmosur nga vetë B. I., siç vërtetohet edhe nga dokumentacioni që FD disponon (bashkëngjitur kësaj shkrese)... B. I. ka pranuar shpalljen fitues në programin Master Profesional Publik... Deri në momentin përpara shpalljes së kandidatëve fitues nuk ka patur asnjë pretendim nga B. I. për diskriminim për shkak të vendbanimit dhe për shkak të gjendjes arsimore. Gjithashtu, përgjatë viteve, në FD nuk është regjistruar asnjë kërkesë me një objekt të tillë shqyrtimi...*

Në vijim të rrethanave të mësipërme, qëndrimin të Rektoratit të UT-së të mbajtur me shkresën nr. 3450/2, date 24.12.2020, si dhe qëndrimin të Fakultetit të Drejtësisë, sqarojmë se do të ndalemi në parashtrimin e arsyeve ligjore se përse Urdhëri nr. 40, datë 30.09.2020, i Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë, mbi kriteret dhe kuotat fillestare të pranimit në programin e ciklit të dytë të studimit për vitin akademik 2020-2021, nuk ka passjellë diskriminimin e aplikantëve për shkak të gjendjes arsimore dhe vendbanimit. Për arsyetimin ligjor të kësaj do të ndalemi në trajtimin e dy çështjeve, së pari, në mënyrën e përcaktimit të kuotave dhe së dyti, në trajtimin e së drejtës për arsim dhe rastet e diskriminimit në arsim. Neni 57 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pavarësisht se kushdo ka të drejtën për arsimim, e ka kushtëzuar ndjekjen e arsimit të lartë vetëm mbi kritere aftësie, që do të thotë se Jo çdo shtetas që dëshiron të ndjekë një program studimi të ciklit të parë apo të dytë, në një institucion të arsimit të lartë, mund të fitojë këtë të drejtë. Kushtetuta gjithashtu në nenin 57, pika 7, ka sanksionuar lirinë akademike dhe autonominë universitare si parimet bazë mbi të cilat ndërtohet dhe funksionon arsimi i lartë në Republikën e Shqipërisë, zbatimi i të cilave garantohet me ligj. Një ndër elementët e autonomisë universitare

⁹ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 459 prot., datë 11.03.2021

është ajo organizative, e cila garantohet edhe nëpërmjet së drejtës për të caktuar kuota dhe kriteret për pranimin e studenteve në programet e studimit, në përputhje me ligjin nr. 80/2015 'Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë'.

Neni 25 i Ligjit Nr. 80/2015, ka parashikuar departamentin si organin përgjegjës për propozimin e kuotave dhe kriterëve të pranimit për çdo program studimi, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe të akteve nënligjore, si edhe për përzgjedhjen e studenteve fitues, të cilët miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, sipas procedurave të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë.

Pra, nisur nga rregullimet ligjore të sipërcituara dhe në mbështetje të Statutit të UT-së, njësitë bazë të Fakultetit të Drejtësisë të UT-së, me qëllim realizimin me sukses të procedurave të aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimeve të ciklit të dytë, për vitin akademik 2020-2021, kanë përcaktuar kuotat dhe kriteret përkatëse, si edhe mënyrën e plotësimit të tyre. Në formulimin e propozimit për kuotat e pranimit, sipas nenit 94 të Statutit të UT-së, pika 4, fakulteti propozues paraqet argumente që lidhen me faktorët e mëposhtëm:

a) misionin dhe objektivat e fakultetit;

b) programin e studimit dhe organizimin e kurrikulës;

c) hapësirat fizike në dispozicion të fakultetit;

ç) gatishmërinë e stafit akademik dhe atij mbështetës, duke vënë theksin tek raporti pedagog student, raporti i pedagogëve të brendshëm me ata të jashtëm dhe niveli i kualifikimit shkencor të stafit akademik;

d) zotërimin e mjeteve didaktike dhe burimeve të literaturës në funksion të metodave të mësimdhënies;

dh) prirjet në kërkesat e kandidatëve për tri vitet e fundit;

e) analizat e kurseve të studimit dhe të diplomave në dritën e kërkesave të tregut për specialistë të profilit përkatës;

ë) veçoritë e programit mësimor, në veçanti raporti leksion-seminar dhe metodat e kontrollit të dijeve.

Sa më sipër, në mbështetje edhe të misionit dhe objektivave të FD-së, si pjesë përbërëse e atyre të UT-së, - të mbetet model i arsimit të lartë publik; prirjeve në kërkesat e kandidatëve për tri vitet e fundit, - numri më i konsiderueshëm i kërkesave për aplikim është nga studentët e brendshëm direkt pas përfundimit të studimeve të tyre Bachelor, dhe parimit mbi të cilin organizohen programet e studimit në UT, - programet e studimit në UT organizohen në tri cikle të njëpasnjëshme', që do të thotë se programi i ciklit të dytë vjen menjëherë ose me ndërprerje të shkurtër në kohë pas ciklit të parë të studimit, por gjithnjë në mënyrë të vijueshme pas njëri tjetrit: UT ka të drejtën dhe detyrimin për t'ju garantuar studentëve të tij një arsimim të vazhdueshëm dhe të pandërprerë, me qëllim sigurimin e rritjes së tyre personale dhe intelektuale.

Për këtë arsye, në Urdhrin nr. 40, datë 30.09.2020, të Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë është parashikuar se kuotat fillestare, ose thënë ndryshe në fazën e parë, do të plotësohen me aplikantë

që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Ky parashikim garanton respektimin e së drejtës për arsim të pandërprerë të vetë studentëve të FD-së dhe njëkohësisht, në përputhje me politikën e garantimit të cilësisë, siguron përthithjen e studentëve më të mirë në treg.

E drejta për arsimim, siç është parashikuar në Kushtetutën tonë, Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), etj., nuk është një e drejtë absolute, por kërkon ndërhyrjen e shtetit për rregullimin e saj, si dhe mund të kufizohet (çështja *Golder vs Mbretëria e Bashkuar*). Kjo do të thotë se institucionet shtetërore të përfshira në organizimin e sistemit arsimor, ndër të tjera dhe më kryesoret institucionet e arsimit të lartë, kanë të drejtën dhe detyrimin, që brenda ratis së ligjit dhe në respektim të parimit të proporcionalitetit, të përcaktojnë masa për rregullimin e kësaj të drejte brenda fushës së tyre të veprimit. Sigurisht, duhet pasur kujdes që këto masa të garantojnë të drejtën për akses në arsimim dhe ndalimin e diskriminimit. Në përputhje me frymën e KEDNJ-së dhe praktikës së konsoliduar të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), e drejta për arsim nënkupton 3 nëndimensione, si: e drejta për akses në arsim; e drejta për arsimim të pandërprerë, që do të thotë garanton vazhdimësinë e rritjes intelektuale, si dhe e drejta për të përfitur nga një arsimim cilësor (çështja *Campbell and Cosans vs Mbretëria e Bashkuar*). Në lidhje me kufizimet apo ndalimin e çdo forme diskriminimi në arsimim, GJEDNJ, në praktikën e saj, ndër të tjera, nuk i ka konsideruar në parim diskriminuese vendosjen e kritereve, kuotave apo provimet hyrëse në një program universiteti. Por, përcaktimi i këtyre kritereve, kuotave apo provimeve duhet t’i nënshtrohen një procesi të parashikueshëm, që do të thotë të garantohet parimi i marrjes dijeni për to, si dhe ai i sigurisë juridike; në rast se duhet të ndryshojnë të parashikohen edhe masa tranzitore si dhe t’i nënshtrohen një procesi njoftimi publik (*Altinay vs Turqi*). Pra, një universitet ka të drejtën të vendosë rregulla për përzgjedhjen e kandidatëve, por duhet t’i bëjë të njohura për palët e interesuara, në mënyrë që të krijojnë një bindje nëse kanë mundësi të bëhen pjesë e këtij institucioni të arsimit të lartë si dhe të njihen me procesin dhe formulën e përzgjedhjes së aplikantëve.

Sa më sipër, pavarësisht se prima facie Urdhri nr. 40, date 30.09.2020, i Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë krijon një konflikt në dukje ndërmjet 2 nëndimensioneve të mësipërme të së drejtës për arsim, - Si e drejta për akses në arsim dhe e drejta për arsim të vazhdueshëm, parashikimi se kuotat fillestare, ose thënë ndryshe në fazën e parë, do të plotësohen nga aplikantë që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, nuk është shkak për diskriminim. Pasi së pari, ky parashikim në kuptim të KEDNJ balancon të drejtën për arsim të vazhdueshëm dhe të drejtën për akses. Së dyti, e gjithë procedura për hartimin e këtij Urdhri është e parashikuar në nenin 94, të Statutit të UT-së dhe përmbajtja e tij i është njoftuar subjekteve të interesuar. Kjo do të thotë, se çdo i interesuar ka pasur mundësinë jo vetëm të njihet me përmbajtjen e tij, por edhe të krijojë bindjen e hershme mbi mundësinë e tij në fillimin e një programi studimi në FD, duke i krijuar kështu edhe mundësinë e kërimit në kohë të të drejtave të tij të pretenduara.

Në këto kushte, Urdhri nr. 40, datë 30.09.2020, i Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë, ka si qëllim respektimin e aksesit dhe të së drejtës për arsim të pandërprerë dhe të vazhdueshëm dhe

realizimi i këtij qëllimi statutor duke përdorur mjete proporcionale, nuk passjell diskriminimin në asnjë rrethanë, e aq më tepër për shkak të gjendjes arsimore dhe vendbanimit për subjekte të tjera të interesuara.

Edhe vetë ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikon ndalimin e diskriminimit në raport me disa aspekte të rëndësishme të arsimit, si:

- krijimin e institucioneve publike ose private, që ofrojnë shërbime arsimore ose profesionale;
- financimin e institucioneve publike, që ofrojnë shërbime arsimore ose profesionale;
- përmbajtjen e parimeve dhe kritereve të veprimtarisë arsimore, duke përfshirë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies;
- trajtimin e studenteve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre;
- refuzimin ndaj një personi ose një grupi personash për t’u pranuar në një institucion arsimor publik, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, apo shqetësimi, përfshirë edhe shqetësimin seksual.

Pra, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me diskriminim, pasi ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga vetë ligji nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Sa u parashtrua më sipër, rezulton se nga ana e Fakultetit të Drejtësisë është zbatuar drejt legjislacioni në fuqi për arsimin e lartë, procesi është zhvilluar në mënyrë transparente bazuar në parimin meritë-preferencë. Ankuesi, B. I., është njohur paraprakisht me kriteret e aplikimit të vendosura dhe të shpallura publikisht, ka rënë dakort me to, ka rezultuar fitues në një program studimi dhe është regjistruar me vullnetin e tij të plotë në të.”

Në përgjigje të kërkesave të paraqitura nga Komisioneri gjatë seancës dëgjimore, Fakulteti i Drejtësisë Tiranë me shkresën¹⁰ Nr. 160/2 prot., datë 09.03.2021, i qëndroi të njëjtave parashtrime me ato të Universitetit të Tiranës dhe sqaroi ndër të tjera se: “...Vendbanimi presupozon se ushtrimi i të drejtave nuk mund të kushtëzohet ose të varet nga vendbanimi i tanishëm ose i mëparshëm i një individi. Kështu, një individ nuk mund të diskriminohet për shkak se jeton ose është regjistruar në një zonë urbane ose rurale, në një vendbanim formal ose jo, apo nëse ka një stil jetese si nomad apo sedentar. Diferencat ndërmjet rajoneve duhet të eliminohen në praktikë duke siguruar një dysheme standardesh të një shpërndarje të barabartë për të gjitha shërbimet publike. Konkretisht, B. I. nuk i është mohuar e drejta për të përfituar nga një shërbim publik, në këtë rast arsimit, por ka qënë dhe është trajtuar i barabartë me të gjithë kandidatet e tjerë aplikantë, në të gjitha fazat e këtij procesi, duke filluar që me aplikimin, përpunimin e të dhënave, përzgjedhjen e kandidatëve fitues dhe shpalljen e fituesve. Dhe fakt konkret dhe i pakundërshtueshëm për këtë është se B. I. aktualisht është student i FDUT-së në një prej programeve të Ciklit të Dytë Master, të renditura prej tij si të preferuar.

¹⁰ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 439 prot., datë 08.03.2021

Gjendja arsimore si shkak diskriminimi, nënkupton nivelin individual të arsimit, arritjet në arsim, aftësitë, certifikatat dhe mundësitë në lidhje me arsimin të cilat një person posedon. Shembull: Diskriminimi për shkak të gjendjes arsimore mund të paraqitet si vendosje e kriterëve për nivelin e arsimit për të aplikuar për një vend të caktuar pune, dhe të cilat nuk janë të arsyeshme dhe të arsyetuara (për shembull, kërkimi i arsimit të lartë për vendin e punës sanitar); ose rasti kur një person ka mbaruar arsimin e lartë 4-vjeçar dhe nuk pranohet të aplikojë ose s'kualifikohet pasi shpallja parashikon arsimin 3+2; ose kur vendoset kriter punësimi arsimit i mbaruar në një universitet të caktuar, pa ndonjë arsye objektive, duke përjashtuar aplikantë që janë arsimuar në universitete tjera...

Nisur nga sa më lart B. I. nuk i është refuzuar në asnjë moment pranimi në institucionin tonë arsimor dhe kjo është lehtësisht e vërtetueshme në të gjitha fazat me dokumentat që institucioni ynë disponon, por që janë të pamohueshme edhe nga vetë ankuesi.

Pra, në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me diskriminim pasi ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga vetë ligji nuk zbatohet në raste kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi.

Gjithashtu kriteret janë të njëjta për të gjitha programet e studimit që ofrohen nga Fakulteti i Drejtësisë, UT dhe shpallja e B. I. fitues rrëzon pretendimet e tij për diskriminim. Po ashtu, pretendimi i ankuesit që ai dhe aplikantë të tjerë të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të janë diskriminuar për shkak të gjendjes arsimore dhe vendbanimit, nuk qëndron, pasi faktet dëshmojnë të kundërtën, ku nga 75 aplikantë për degë të parë, nga institucionet e tjera publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, 65 janë shpallur fitues.

Gjithashtu, fakt tjetër që rrëzon pretendimet për diskriminim është edhe se nëse do të verifikojmë listat e fituesve ku B. I. është shpallur fitues do të shikojmë se edhe aplikantë nga Fakulteti i Drejtësisë, UT, të shpallur fitues në të njëjtën listë me ankuesin janë shpallur fitues në preferencën e tyre të katërt (4), çka dëshmon edhe njëherë që trajtimi ka qënë i barabartë dhe i njëjtë për të gjithë, bazuar në kriteret e shpallura dhe të bëra publike...

Pra, nisur nga sa më sipër ankuesit nuk i është mohuar në asnjë rast e drejta për aplikim, e drejta për të ndjekur studimet dhe as e drejta për të marrë një shërbim publik, konkretisht siç është mësimdhënia cilësore dhe e njëjtë me të gjithë studentët e tjerë, ashtu siç po ndodh edhe në këto momente që ne jemi duke folur, pasi B. I. është student pranë FDUT... ”

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje objekt i ankesës dhe që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin disfavorizues dhe të pabarabartë.

Ligji Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “*Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi*”.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

LMD¹¹ në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: “*2. Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij.*”.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se:

Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 25, të tij, ka parashikuar se: “*...7. Departamenti propozon programet e studimit, si edhe numrin e studentëve për çdo program, në përputhje me kapacitetet akademike dhe infrastrukturore të tij, sipas standardeve të cilësisë.*

8. Departamenti propozon kriteret e pranimit të studentëve për secilin program studimi, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe të akteve nënligjore. Departamenti përzgjedh studentët fitues, të cilët miratohen nga drejtuesi i njësisë kryesore, sipas procedurave të përcaktuara në statutin dhe rregulloret e institucionit të arsimit të lartë...”.

Referuar informacionit të vënë në dispozicion, njësitë bazë (Departamentet përkatëse) të Fakultetit të Drejtësisë së UT-së, miratuar me Urdhër nr. 40, datë 30.09.2020 të Dekanit të FD, si organet përgjegjëse për përcaktimin e kriterëve për pranimin për çdo program studimi, kanë përcaktuar kriteret e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimeve të ciklit të dytë, për vitin akademik 2020-2021, të cilat ishin:

1. Nota mesatare minimale për të aplikuar për Master Shkencor është 6.5 (gjashtë pikë pesë).
2. Nota mesatare minimale për të aplikuar për Master Profesional është 5 (pesë).
3. Nota mesatare minimale për të aplikuar për Master Profesional EU Business Law është 5 (pesë).

¹¹ Shkurtesë e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar.

4. Niveli minimal i njohjes së një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: anglisht, frengjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht, është B 1; (Ky kriter është i zbatueshem vetëm për kandidatët që aplikojnë për “Master Shkencor”).

Gjithashtu, kanë përcaktuar edhe mënyrën e plotësimit të kuotave, sipas rendit të mëposhtëm:

- i. Kuotat fillestare do të plotësohen duke u dhënë prioritet aplikantëve që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, si edhe aplikantëve që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në Institucionet e Arsimit të Lartë jashtë vendit.
- ii. Kuotat e paplotësuara nga kategoria e mësipërme, do të plotësohen nga aplikantët që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në institucionet e tjera publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në programin Drejtësi; si edhe në programin “Ekonomi” për “Master Profesional EU Business Law”.
- iii. Kuotat e paplotësuara nga kategoritë e mësipërme, do të plotësohen nga aplikantët që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në institucionet e tjera jopublike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në programin “Drejtësi”.

Në datën 01.10.2020, në ambjentet e Fakultetit të Drejtësisë, është afishuar njoftimi për aplikimet në programet e studimeve të ciklit të dytë, për vitin akademik 2020-2021, në mënyrë që aplikantët të ishin në dijeni të kriterëve dhe të mënyrës së plotësimit të kuotave.

Pasi është vënë në dijeni të njoftimit të sipërcituar, ankuesi më datë 05.10.2020 është paraqitur pranë Sekretarisë së Fakultetit të Drejtësisë Tiranë dhe ka plotësuar Formularin e Aplikimit, në të cilin ka renditur programet e studimit sipas preferencës së më poshtme:

1. Master Shkencor Civil (1)
2. Master Shkencor Penal (6)
3. Master Shkencor Publik (3)
4. Master Profesional Civil (2)
5. Master Profesional Penal (7)
6. Master Profesional Publik (4)
7. Master Profesional EU Business Law (5)

Në Kreun IV/1, të Udhëzimit Nr. 17, datë 30.07.2019 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin Nr. 10, datë 15.05.2019 ‘Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë”*, përcaktohet se: *“...12. Aplikimet për transferimet e studimeve dhe për transferimin e studimeve dhe për program të dytë studimi shqyrtohen nga komisioni/komisionet i/e ngritur/a për këtë qëllim nga IAL-ja brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi. Komisionet kryejnë vlerësimin e dosjeve në zbatim të kuadrit*

ligjor e nënligjor në fuqi, si dhe të kriterëve të tjera të shpallura para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, bazuar në pikëzimin për çdo kriter vlerësimi, e cila shpallet nga dekani përkatës në mjediset e fakultetit të IAL-së, si dhe në faqet web përkatëse, e plotësuar sipas tabelave 1a dhe 1b, të shtojcës nr. 8 të këtij udhëzimi.

IAL-të, për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat me renditjen e kandidatëve brenda datës së përcaktuar në shtojcën nr. 10, të këtij udhëzimi. Në listën e publikuar nga ana e IAL-ve, fituesi i fundit përcaktohet me vijë të kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit. Në këtë listë bëhen me dije pikët vlerësuese për çdo kriter vlerësimi.”

Në zbatim të udhëzimit të sipërcituar, Komisioni i ngritur për përzgjedhjen e kandidatëve fitues për programet e studimeve të ciklit të dytë në vitin akademik 2020-2021, pasi ka shqyrtuar plotësimin e kriterëve dhe preferencat sipas Fletë Aplikimit të ankuesit, arriti në këto përfundime:

- *B. I. nuk është shpallur fitues në preferencën e tij të parë (1), pasi kuotat janë plotësuar me aplikantë që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, si edhe aplikantëve që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në Institucionet e Arsimit të Lartë jashtë vendit.*
- *B. I. nuk është shpallur fitues në preferencën e tij të dytë (2), pasi kuotat janë plotësuar me aplikantë që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, 1 aplikant që ka përfunduar studimet “Bachelor” në Institucionet e Arsimit të Lartë jashtë vendit, si dhe 3 aplikantë që kanë përfunduar studimet Bachelor në institucionet e tjera publike të Republikës së Shqipërisë, por që ndryshe nga B. I. këtë program studimi e kanë pasur preferencë të parë (1).*
- *B. I. nuk është shpallur fitues në preferencën e tij të tretë (3), pasi kuotat janë plotësuar me aplikantë që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës.*
- *B. I. është shpallur fitues në programin e studimit Master Profesional në të “Drejtë Publike”, që rezulton të jetë edhe preferenca e tij e katërt (4).*

Në Udhëzimin nr. 17, datë 30.07.2019 të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit, përcaktohen procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në programet e ciklit të dytë të studimeve në IAL. Në pikën 13, ky Udhëzim ka përcaktuar se kandidatët kanë të drejtën e ankimit në IAL, brenda 3 ditëve kalendarike nga dita e shpalljes së rezultateve. IAL detyrohen të shprehen me vendim të argumentuar lidhur me ankimin brenda dy ditëve pune, nga data e paraqitjes së ankesave.

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga palët, nuk rezulton që ankuesi B. I. apo aplikant të tjerë të kenë paraqitur ankimim, për shkak të rezultateve të shqyrtimit të aplikimit të tij, apo për shkak se nuk janë shpallur fitues në programin e studimit të renditur si preferencë e parë.

Në përfundim, ankuesi rezulton të jetë paraqitur pranë Sekretarisë së Fakultetit të Drejtësisë, ku ka plotësuar formularin për regjistrimin e tij në programin e studimit në të cilin ishte shpallur fitues, Master Profesional Publik.

Lidhur me sa më sipër, në kontekst të përmbushjes dhe plotësimit të kritereve të përcaktuara, Komisioneri konstaton se:

- *Lidhur me kriteret e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimeve të ciklit të dytë, për vitin akademik 2020-2021:*

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në Nenin 57, të saj parashikon se:

“1. Kushdo ka të drejtën për arsimin.

2. *Arsimi shkollor i detyrueshëm caktohet me ligj.*

3. *Arsimi i mesëm i përgjithshëm publik është i hapur për të gjithë.*

4. Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie.

5. *Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.*

6. *Nxënësit dhe studentët mund të arsimohen edhe në shkolla jopublike të të gjitha niveleve, të cilat krijohen e funksionojnë në bazë të ligjit.*

7. *Autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj.”*

Në të njëjtën frymë, Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 1, përcakton se:

“Arsimi i lartë është e mirë dhe përgjegjësi publike dhe ka për mision: a) të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor, si dhe të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet; b) të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend; c) të ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë të gjithë jetës;...”

Ndërsa në nenin 2/dh, Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, përcakton se: “Ky ligj ka për qëllim: dh) të garantojë mundësi të barabarta, mbi bazën e meritës, për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë;

Në nenin 7 të Statutit të Universitetit të Tiranës, citohet se: “4. Autonomia organizative dhe e përzgjedhjes së personelit garantohet nëpërmjet së drejtës: a) për t’u vetëqeverisur, për të zgjedhur organizmat drejtues, për të organizuar strukturat dhe për të rregulluar mënyrat e ushtrimit të veprimtarisë së tyre nëpërmjet akteve të brendshme të institucionit; b) për të caktuar kritere për pranimin e studentëve në programet e studimit, në përputhje me përcaktimet ligjore;”

Në nenin 94, pika 5 të Statutit të Universitetit të Tiranës, përcaktohet se: *“Kanë të drejtë të aplikojnë për t’u regjistruar në ciklin e dytë të studimeve:*

a) Kandidatët që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë, si në fakultetin në të cilin është kryer programi i ciklit të parë ose në një fakultet tjetër, kjo në përputhje me kriteret e programit mësimor përkatës dhe ato të ministrisë përgjegjëse për arsimin;

b) Kandidatët që zotërojnë diplomë studimi të fituar jashtë vendit, të vlerësuar të barasvlershme me të;

c) Individët që kanë rezultate të larta në studimet e ciklit të parë, në përputhje me kriteret e shpallura;

ç) Kandidatët që plotësojnë standardet e caktuara akademike të kriterëve të pranimit në ciklin e dytë të studimeve;...”

Gjithashtu, Rregullorja e Universitetit të Tiranës, miratuar me Vendim nr. 5, datë 12.04.2010 të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, të ndryshuar, në Nenin 44, parashikon se: *“Personat që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi. Në këtë rast pranohen për aplikim si rregull, kandidatët me diplomë të përafërt me programin e dytë në të cilin kërkojnë të studiojnë, nga të cilët përzgjidhen ata me mesatare më të lartë. Në këtë rast, kandidatët përballojnë koston e plotë të studimeve.*

Nga ky rregull, përjashtohen studentët e shkëlqyer sipas kriterëve dhe procedurave që parashikon ligji për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.”

Në zbatim të sa mësipër, Departamentet përkatëse dhe Fakulteti i Drejtësisë së Universitetit të Tiranës, nëpërmjet Urdhrit nr. 40, datë 30.09.2020, kanë përcaktuar kriteret e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimeve të ciklit të dytë, nëpërmjet të cilave u kanë dhënë prioritet fillimisht aplikantëve që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, aplikantëve që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në Institucionet e Arsimit të Lartë jashtë vendit, e në përfundim kuotat e paplotësuara nga kategoria e mësipërme, do të plotësohen nga aplikantët që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në institucionet e tjera publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në programin Drejtësi.

Mbështetur në provat e administruara, Fakulteti i Drejtësisë, nuk ka vënë në dispozicion të Komisionerit asnjë akt, procesverbal apo dokumentacion tjetër, në të cilin të citohen arsyt objektive të cilat kanë çuar në vendosjen e kriterit që aplikantët të kenë përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve bachelor në Fakultetin e Drejtësisë të UT. Sipas informacionit të dhënë gjatë shqyrtimit të ankesës, nga ana e Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Drejtësisë, *kriteret e vendosura garantojnë respektimin e së drejtës për arsim të pandërprerë të vetë studentëve të FD-së dhe njëkohësisht, në përputhje me politikat e garantimit të cilësisë, siguron përthithjen e studentëve më të mirë në treg.*

Në këtë kuptim, referuar këtij parashikimi, Fakulteti i Drejtësisë nëpërmjet vendosjes së këtij kriteri ka diferencuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë të gjithë kandidatët që nuk kanë përfunduar studimet bachelor në Fakultetin e Drejtësisë të UT-së. Gjithashtu, edhe pse ankuesi ka patur mesataren e ciklit të parë të studimeve në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, përkatësisht më të lartë se 37 (tridhjetë e shtatë) studentë të Fakultetit të Drejtësisë së UT-së, nuk është shpallur fitues në programin e ciklit të dytë të studimeve Master Shkencor Civil, të cilën e ka patur preferencë të parë në Formularin e Aplikimit. Në këtë kuptim, ankuesi në mënyrë të drejtëpërdrejtë është përjashtuar nga e drejta për të ndjekur studimet në këtë program studimi, duke u trajtuar kështu në mënyrë të padrejtë dhe të pabarabartë në krahasim me 37 (tridhjetë e shtatë) kandidat fitues.

Në interpretim për sa më sipër, Komisioneri vëren se aktet ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, parashikojnë në një frymë, të drejtën për arsim dhe mundësi të barabarta për të përfituar arsim të lartë. I vetmi kufizim që sanksionohet në Kushtetutën e RSH-së dhe legjislacionin e cituar më sipër, është garantimi i mundësive të barabarta, *mbi bazën e meritës*, për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë.

Në përfundim të arsyetimit, ankuesi dhe aplikantët të cilët ndodhen në të njëjtat kushte me të janë trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të padrejtë në krahasim me aplikantët e tjerë (të cilët kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në Fakultetin e Drejtësisë në UT), pasi janë përjashtuar për shkak se nuk kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në Fakultetin e Drejtësisë në UT.

Neni 14, pika 5/dh/e¹², neni 47, pika 1/dh¹³, neni 34, pika 1/e/ë¹⁴ dhe 94, pika 3¹⁵ të Statutit të Universitetit të Tiranës, përcaktojnë në mënyrë të qartë, kompetencën e secilës strukturë në organizimin e procesit të konkurimit për programin e ciklit të dytë të studimeve në Fakultetin e Drejtësisë dhe Universitetin e Tiranës. Në këtë kuptim, konstatohet se përgjegjës kryesor në miratimin e kriteve për programin e ciklit të dytë të studimeve janë strukturat e Fakultetit të

¹²I cili parashikon se: “*Departamenti ushtron këto kompetenca në fakultete: ... dh) Përzgjedh studentët fitues, për programet e studimit që ofron, të cilët miratohen nga dekani, sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit përkatës, pjesë përbërëse e së cilës ai është;*”

e) *Propozon kriteret e pranimeve në tri ciklet e studimit për secilin program studimi që ofron; ...*”

¹³ I cili përcakton se: “*Dekani kryen këto funksione: “...dh) Miraton kriteret e pranimit të studentëve, sipas propozimeve të departamenteve për të gjitha programet e studimit; ...*”

¹⁴ I cili përcakton se: “*Rektori kryen funksionet si më poshtë: “...e) Trajton ankesat e bëra ndaj vendimeve të organeve të ndryshme të fakulteteve dhe u propozon strukturave përkatëse marrjen e vendimeve në lidhje me to, në përputhje me legjislacionin në fuqi; ë) Ushtron kontrolle, kryesisht apo me kërkesë të organeve drejtuese të Universitetit, për cilësinë e mësimdhënies, kërkimit shkencor, zbatimit të kontratave të punës dhe për çdo veprimtari tjetër që kryejnë fakultetet; ...*”

¹⁵ 3. *Çdo njësi kryesore ka për detyrë të bëjë publike kriteret e përcaktuara nga departamentet jo më vonë se data 20 Dhjetor e vitit paraardhës kalendarik, për të gjitha programet e studimit që ofron. Si rregull, këto kritere nuk mund të ndryshohen deri në përfundim të procesit të pranimeve të reja. Kriteret i përcillen Rektoratit, i cili ka për detyrë t’ia përcjellë MASR.*

Drejtësisë së UT-së; Departamentet dhe Dekani, ndërsa Rektori, nuk është përgjegjës sa i përket përcaktimit të kriterëve apo miratimit të tyre.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se, kemi një diferencë në trajtim ndërmjet ankuesit dhe aplikantëve të tjerë të cilët kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në Fakultetin e Drejtësisë në UT, duke mos i dhënë mundësi njëlloj si të tjerët për të përfituar nga programet e studimit master në Fakultetin e Drejtësisë të UT-së.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2¹⁶, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se subjekti ankues është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që perfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet subjektit ankues dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur, apo në krahasim me parashikimet ligjore, në kushtet kur mungon krahasuesi.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Ankuesi ka pretenduar në thelb, trajtim të padrejtë, nga ana e Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Drejtësisë, për shkak të gjendjes arsimore dhe vendbanimit.

Komisioneri në rastin konkret, me gjendje arsimore, kupton faktin që ankuesi disponon një diplomë të nivelit të parë të studimeve përfunduar në një universitet tjetër dhe jo në Fakultetin e Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës, siç është përcaktuar në kriteret për

¹⁶“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo forme sjelljeje qe nxit diskriminim.”

programet e ciklit të dytë të studimeve (në Fakultetin të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës). Në këtë rast, gjendjen arsimore, Komisioneri e vlerëson si shkak të mbrojtur të LMD-së.

Sa i përket shkakut të vendbanimit, mbështetur në provat¹⁷ e vëna në dispozicion, ankuesi e lidh këtë shkak me faktin që ai banon në qytetin e Elbasanit dhe ka përfunduar ciklin e parë të studimeve në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë me shkakun e mbrojtur.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përlligje e arsyeshme për trajtimin ndryshe të evidentuar.

Bazuar në dokumentacionin që disponon nga hetimi, Komisioneri vlerëson se ankuesi mbart shkaqet e mbrojtura *“të gjendjes arsimore dhe vendbanimit”*.

Lidhur me sa më lart, Komisioneri ka vlerësuar se ka patur një diferencë në trajtim mes ankuesit dhe aplikantëve të tjerë të cilët kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në Fakultetin e Drejtësisë në UT, nga ana e Fakultetit të Drejtësisë Tiranë.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Ky parim përshkon edhe nenin 57 të Kushtetutës sipas të cilit *“1. Kushdo ka të drejtën për arsimim;...4. Arsimi i mesëm profesional dhe i lartë mund të kushtëzohet vetëm nga kritere aftësie.”*. Dispozita kushtetuese i garanton çdo personi të drejtën për arsimim.

Pra, e drejta kushtetuese për t’u arsimuar në arsimin e lartë shihet si një e drejtë e hapur dhe e garantuar për të gjithë. Dispozita kushtetuese lë vetëm eventualisht mundësinë që i vetmi kufizim për zgjedhës që mund të bëhet në arsimin e lartë mund të lidhet vetëm me kritere aftësie.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive

¹⁷ Certifikatë personale, në të cilën citohet se vendbanimi i ankuesit, Elbasan.

themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë “në gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në të. Protokollin 12-të i saj ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa Neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.¹⁸

Neni 2 i Protokollit nr. 1, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, parashikon se: *“Askujt nuk mund t’i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.”*

E drejta për arsim reflektohet edhe në të drejtën ndërkombëtare në nenin 26 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe nenet 13 dhe 14 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore . Në nenin 26 thuhet: *“Të gjithë kanë të drejtë në arsim. Arsimi do të jetë falas, të paktën në fazat fillestare dhe themelore. Arsimi fillor do të jetë i detyrueshëm. Edukimi teknik dhe profesional do të vihen përgjithësisht në dispozicion dhe arsimi i lartë do të jetë njësoj i arritshëm për të gjithë në bazë të meritave... ”.*

Një akt tjetër në mbrojtje të së drejtës për arsimim/të drejtës së edukimit është Konventa Kundër Diskriminimit në Arsim miratuar në 1960 (Konventa e UNESCO-s), e ratifikuar edhe nga Shqipëria. Kjo Konventë mbron të gjithë qytetarët e shteteve palë nga diskriminimi në arsim për çdo lloj shkak. Gjithashtu, ajo i kërkon shteteve të ndërmarrin masa për të formuluar, zhvilluar dhe zbatuar politika kombëtare të cilat promovojnë trajtimin e barabartë në çështje, që lidhen me edukimin.

Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (1969)¹⁹ e cilëson të drejtën e arsimimit si të drejtë universale. Kjo natyrë i vishet kësaj të drejte, sipas parashikimeve të nenit 13 të Paktit, pasi ajo shtrin garancinë për çdo individ pavarësisht nga mosha, gjuha, origjina ose status tjetër. Neni 13, pika 2 parashikon që: *“2. Shtetet palë të këtij Pakti pranojnë se për të arritur realizimin e plotë të kësaj të drejte: ...c) Arsimi i lartë duhet të bëhet i hapur për të gjithë në mënyrë të barabartë sipas aftësive të secilit, me të gjitha mjetet e përshtatshme e sidomos me vendosjen progresive të ndjekjes së mësimi falas;...”*

¹⁸ https://www.echr.coe.int/Documents/Handbook_non_discr_law_SQL.pdf, faqet 47 dhe 49

¹⁹ Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore datë 16.12.1969, ratifikuar nga shteti Shqiptar më datë 4 Tetor 1991.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 17, parashikon se: “1. Ndalohet çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me:

- a) krijimin e institucioneve publike ose private që ofrojnë shërbime arsimore ose profesionale;
- b) financimin e institucioneve publike që ofrojnë shërbime arsimore ose profesionale;
- c) përmbajtjen e parimeve dhe kritereve të veprimtarisë arsimore, duke përfshirë programet mësimore dhe metodat e mësimdhënies;
- ç) trajtimin e studentëve ose nxënësve, duke përfshirë pranimin, vlerësimin, zbatimin e masave disiplinore ose përjashtimin e tyre.

2. Ndalohet t’i refuzohet një personi ose një grupi personash pranimi në një institucion arsimor publik, për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji...”.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës. Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS²⁰ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin nenin 33, pika 7/1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se : “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim.” I njëjti rregullim në lidhje me barrën e provës parashikohet edhe në nenin 82, pika 2 e Kodit të Procedurës Administrative, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Kodi i Procedurës Administrative²¹ dhe Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”²², i ndryshuar, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës

²⁰ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

²¹ Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej tij”.

²² Neni 33, pika 7/1 e Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikon: “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”

tjetër/organit publik, në këtë rast strukturave të Fakultetit të Drejtësisë, të cilët duhet të provonin se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, për shkaqet e pretenduara prej tij.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Pasi personi që pretendon diskriminim krijon një prezumim të diskriminimit (diskriminimi prima facie), barra më pas kalon tek subjekti, i cili duhet të tregojë se **ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues**. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka *një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv*. Nëse diskriminuesi i pretenduar nuk është në gjendje të provojë një të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.²³

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjektet kundër të cilëve është bërë ankesa të vihen në dijeni dhe i janë ofruar mundësitë që të japin shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Në analizë përse më sipër, Komisioneri prezumon faktin se ankuesi është trajtuar në mënyrë të diferencuar dhe diskriminuese, duke u mbështetur në faktin që:

- ka përmbushur të gjitha kushtet e tjera dhe fakti që nuk ka mbaruar në Fakultetin e Drejtësisë Tiranë, ka qënë faktori i vetëm dhe deçiziv që e ka përjashtuar atë nga e drejta për të vazhduar studimet në programin e ciklit të dytë që ai kishte përzgjedhur si preferencë të parë.
- studentët me mesatare më të ulët se ankuesi, janë përzgjedhur për të vijuar ciklin e dytë të studimeve për programin Master Shkencor Civil, vetëm për faktin se kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve në UT;

²³ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

Sa më sipër, në rastin në shqyrtim duket qartë që ka një lidhje mes trajtimit të diferencuar dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur të gjendjes arsimore. Në këtë moment, Komisioneri do të vlerësojë nëse një diferencë e tillë justifikohet objektivisht, pra specifikisht:

- A ndjek një qëllim legjitim?
- A janë mjetet e përdorura në mënyrë të arsyeshme, proporcionale me qëllimin e ndjekur?

1. A ndjek një qëllim legjitim?

Referuar pretendimeve të Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Drejtësisë, evidentohet se ata janë udhëhequr nga parimet:

- *Për t'ju garantuar studentëve të tyre një arsimim të vazhdueshëm dhe të pandërprerë, me qëllim sigurimin e rritjes së tyre personale dhe intelektuale;*
- *Për të përzgjedhur studentët në përputhje me politikën e garantimit të cilësisë, me qëllim sigurimin e përthithjes së studentëve më të mirë në treg;*

Fakulteti i Drejtësisë dhe Universiteti i Tiranës, kanë pretenduar se referuar vendimmarrjes së GJEDNJ-së, vendosja e kriterëve, kuotave apo provimet hyrëse në një program universiteti nuk është konsideruar në parim diskriminuese. Pra, një universitet ka të drejtën të vendosë rregulla për përzgjedhjen e kandidatëve, por duhet t'i bëjë të njohura për palët e interesuara, në mënyrë që të krijojnë një bindje nëse kanë mundësi të bëhen pjesë e këtij institucioni të arsimit të lartë si dhe të njihen me procesin dhe formulën e përzgjedhjes së aplikantëve.

Pavarësisht pretendimit të sipërcituar, Komisioneri nuk ka mbajtur një qëndrim për të cilin të konstatojë se, vendosja e kriterëve, kuotave apo provimeve hyrëse në një program universiteti të konsiderohet diskriminuese. Por, referuar edhe rasteve²⁴ të tjera të trajtuara nga Komisioneri, vendosja e kriterëve të cilat vënë në pozita të pafavorshme dhe të pabarabarta, subjektet, në rastet kur këto masa nuk ndjekin një qëllim legjitim apo mjetet e përdorura për arritjen e qëllimit legjitim nuk janë të arsyeshme apo propocionale, përbën një sjellje diskriminuese.

Në analizë të legjislacionit shqiptar cituar në vendim, duke nisur nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si dhe Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet shumë qartë se e drejta për arsim mund të kushtëzohet vetëm nga kriterë aftësie, si dhe qëllimi i ligjit nr.80/2015 është të garantojë mundësi të barabarta, mbi bazën e meritës, për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë.

²⁴ Vendimi Nr. 41, datë 29.04.2020, i KMD-së

Në analizë të parashtrimeve të Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Drejtësisë Tiranë, është sjellë si qëllim kryesor legjitim, detyrimi dhe e drejta që ato kanë *për t'ju garantuar studentëve të tyre një arsimim të vazhdueshëm dhe të pandërprerë, me qëllim sigurimin e rritjes së tyre personale dhe intelektuale.*

Këtë qëllim subjektet e interpretojnë duke cituar *çështjen e shqyrtuar nga GJEDNJ “Campbell and Cosans vs Mbretëria e Bashkuar”,* por theksojmë që subjektet nuk kanë shpjeguar dhe argumentuar termin *“e drejta për një arsim të vazhdueshëm dhe të pandërprerë”* dhe lidhjen e këtij termi me vendimin e cituar të GJEDNJ-së të cilit i referohen.

Në shqyrtim të vendimit të GJEDNJ-së *“Campbell and Cosans vs Mbretëria e Bashkuar”,* Komisioneri arrin në konkluzionin që vendimi i mësipërm solli qëndrime shumë të rëndësishme për të drejtën e një mësuesi për të zbatuar ndëshkimin trupor dhe të drejtën që një studenti t'i mohohet arsimi sepse ai ose ajo nuk dëshironte të merrte dënim trupor. Në këtë vendim, GJEDNJ konstatoi që shteti në fjalë nuk kishte respektuar bindjet filozofike të prindërve, duke gjetur shkelje të nenit 2 i Protokollit nr. 1 të Konventës: *E drejta për arsimim “Askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për arsimim. Shteti, në ushtrimin e funksioneve që merr përsipër në fushën e edukimit dhe të arsimit, respekton të drejtën e prindërve për të siguruar këtë edukim dhe arsim në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike.”*

Sa më sipër, Komisioneri e gjen të pabazuar referencën e këtij vendimi në parashtrimet e FD-së lidhur me legjitimitimin e detyrimit dhe të drejtës *për t'ju garantuar studentëve të tyre një arsimim të vazhdueshëm dhe të pandërprerë, me qëllim sigurimin e rritjes së tyre personale dhe intelektuale.* Gjithashtu, nga analiza e të gjithë akteve ligjore dhe nënligjore, nuk parashikohet që përzgjedhja e aplikantëve të bëhet duke përfutur më parë ata nga Institucionet e Arsimit të Lartë në të cilat kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor.

Edhe pse një parim i tillë nuk ekziston i shprehur ekspresivisht në ndonjë Akt Ndërkombëtar, ligj, akt nënligjor apo statutor, Komisioneri vlerëson që gjithsesi, pandërpreja e studimeve duhet të garantohet për çdo person në të gjitha ciklet e studimit, i cili në bazë të aftësive të tij, mund ti ndjekë studimet në çdo Institucion të Arsimit të Lartë. Interpretimi i ngushtë që Fakulteti i Drejtësisë Tiranë bën, nuk gjen asnjë arsye objektive dhe e përcakton përzgjedhjen e kandidatëve në cilësi të tyre në bazë statusi dhe jo në kritere aftësie.

Në analizë sa më sipër, Komisioneri nuk e gjen të mbështetur në aktet ligjore të Republikës së Shqipërisë, si dhe në ato të ratifikuara apo edhe në vendimet e GJEDNJ-së të cituara nga subjektet ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, qëllimin e sjellë prej këtyre subjekteve, dhe si pasojë e konsideron atë një qëllim jo legjitim.

- Sa i takon parimit tjetër, *“për të përzgjedhur studentët në përputhje me politikat e garantimit të cilësisë, me qëllim sigurimin e përthithjes së studentëve më të mirë në*

treg, në të cilin FD është udhëhequr për të justifikuar vendosjen e kriterëve kufizuese, Komisioneri vlerëson se :

Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, parashikon si qëllim të ligjit të krijojë mekanizma të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me standardet europiane; por njëkohësisht po ky ligj parashikon si një nga qëllimet e tij edhe të garantojë mundësi të barabarta, mbi bazën e meritës, për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë.

Në analizë përse më sipër, Komisioneri e konsideron këtë qëllim në vetvete si legjitim, pasi është në të njëjtën frymë me legjislacionin e arsimit të lartë.

Pyetja që lind është: A kemi në këtë rast një marrëdhënie të arsyeshme të proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet?

Sipas nenit 12/2 të Kodit të Procedurave Administrative, veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit, vetëm kur ky veprim është:

- I nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që çënojnë më pak të drejtat apo interesat e ligjshme të palës.
- I përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar nga ligji dhe
- Në përpjestim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

Në vendimin nr. 20, datë 11.07.2006, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: “.....nga të gjitha mjetet e ndryshme që mund të shfrytëzohen për të arritur një qëllim të ligjshëm, autoriteti administrativ duhet të përdorë mjetet ligjore më të përshtatshme, me të cilat, mund të arrihet në shkaktimin e padrejtësisë më të vogël për një individ. Prandaj duhen përdorur vetëm mjetet që shkaktajnë padrejtësinë minimale për individin dhe me masa sa më pak të dëmshme për të. Kjo nënkupton elementin e dytë të parimit. Ky parim kërkon detyrimisht dhe plotësimin e kushtit të tretë, sipas të cilit ndërhyrja në të drejtat e individit nuk duhet të jetë jashtë raportit të qëllimeve të aspiruara. Në këtë mënyrë, përfshirja e tre elementëve të domosdoshëm kërkon, që një masë ose mjet, duhet të jetë i përshtatshëm dhe i nevojshëm për të arritur një qëllim të kërkuar dhe mjete e qëllimi të qëndrojnë në përpjestim të arsyeshëm.”

Sigurisht, sigurimi i cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, përbën një qëllim shumë të rëndësishëm, por a janë këto kriterë kufizuese mjetet e duhura e të domosdoshme për të arritur këtë qëllim? A ka mjete të tjera të cilat mund të përdoren nga Fakulteti i Drejtësisë për të arritur këtë qëllim, pa çenuar të drejtën për mundësi të barabarta, mbi bazën e meritës, për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë.

Rregullorja e Universitetit të Tiranës, miratuar me Vendim nr. 5, datë 12.04.2010 të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, të ndryshuar, në Nenin 44, parashikon se: *“Personat që kanë përfunduar një program studimi, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi. Në këtë rast pranohen për aplikim si rregull, kandidatët me diplomë të përafërt me programin e dytë në të cilin kërkojnë të studiojnë, nga të cilët përzgjidhen ata me mesatare më të lartë. Në këtë rast, kandidatët përballojnë koston e plotë të studimeve.*

Nga ky rregull, përjashtohen studentët e shkëlqyer sipas kriterëve dhe procedurave që parashikon ligji për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.”

Në rastin konkret Fakulteti i Drejtësisë së Universitetit të Tiranës, nëpërmjet Urdhrit nr. 40, datë 30.09.2020, ka përcaktuar kriteret e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e studimeve të ciklit të dytë, nëpërmjet të cilave u ka dhënë prioritet fillimisht aplikantëve që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, aplikantëve që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në Institucionet e Arsimit të Lartë jashtë vendit, e në përfundim kuotat e paplotësuara nga kategoritë e mësipërme, do të plotësohen nga aplikantët që kanë përfunduar studimet “Bachelor” në institucionet e tjera publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në programin Drejtësi.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson që Urdhri nr. 40, datë 30.09.2020 i Fakulteti i Drejtësisë së Universitetit të Tiranës nuk është në një linjë me Rregulloren e Universitetit miratuar me Vendim nr. 5, datë 12.04.2010 të Senatit Akademik të Universitetit të Tiranës, të ndryshuar, i cili nuk bën diferencim në faktin se në cilin Universitet kanë mbaruar studimet kandidatët, por bazohet vetëm në kriterin e mesatares, kriter i përligjur ky edhe nga akte të tjera ligjore duke nisur që nga Kushtetuta e RSH-së.

Gjithashtu, Komisioneri sjell në vëmendje edhe pasojat që do të kishte në të ardhmen vendosja e këtyre kriterëve. Kushtëzimi me faktin që duhet të kesh përfunduar studimet e ciklit të parë të studimeve pranë FDUT-së, do të sillte si pasojë detyrimin e studenteve që preferojnë të vazhdojnë studimet master pranë FDUT, që medoemos të ndjekin studimet e ciklit të parë pranë këtij Fakulteti.

Në këtë kontekst, nga parashtrimet e FDUT-së, nuk u paraqitën fakte, prova që të tregojnë para Komisionerit se ku është mbështetur Fakulteti për të arritur në përfundimin se trajtimi i barabartë i të gjithë studentëve, pavarësisht ku ata kanë studiuar, duke u bazuar vetëm në merita, siç është nota mesatare, çënon cilësinë e tij. Përkundrazi Komisioneri vlerëson faktin se mbështetja tek kriteri i notës mesatare do ishte një arsye që do çonte në rritjen e cilësisë.

Sa më sipër Komisioneri vlerëson se kufizimet e bazuara në faktin që studentët kanë mbaruar apo jo studimet e cikllit të parë pranë FDUT, nuk janë proporcionale me qëllimin që mendohet të arrihet. Si pasojë këto kritere vlerësohen si diskriminuese.

Ligji Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 2, parashikon se: “Diskriminim i drejtëpërdrejtë është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.”.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se ankuesi, diskriminohet në mënyrë të drejtëpërdrejtë për shkak të gjendjes së tij arsimore, përmes vendosjes së kriterit që aplikantët duhet të jenë të diplomuar në ciklin e parë të studimeve bachelor në Fakultetin e Drejtësisë të UT, duke sjellë skualifikimin e tij për programin e preferuar të ciklit të dytë të studimeve.

Sa i përket pretendimeve të ankuesit për diskriminim lidhur me vendbanimin, Komisioneri nuk arriti të administrojë prova dhe fakte nga palët se, studentët që kanë aplikuar për një nga programet e ciklit të dytë të studimeve Master në Fakultetin e Drejtësisë Tiranë, kanë patur vendbanimin e tyre në Tiranë, apo të mund të krahasoheshin me ankuesin. Pra, në mungesë të informacionit nga ana e palëve në proces, nuk arrin të konstatojë këtë pretendim të tij.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë, për shkak të gjendjes arsimore, në fushën e arsimit, të B. I., nga ana e Fakultetit të Drejtësisë në UT.
2. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të vendbanimit, të B. I., nga ana e Universitetit të Tiranës dhe Fakultetit të Drejtësisë në UT.
3. Universiteti i Tiranës dhe Fakulteti i Drejtësisë të marrin masat për hartimin e kriterëve për programet e ciklit të dytë të studimeve në mënyrë që aplikantët të konkurojnë në kushte të barabarta dhe bazuar në kriteret aftësie.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Fakulteti i Drejtësisë Tiranë, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.

5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja arsimore)

(Fusha: Arsim)